**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier**

**Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve për Periudhën: 01 Janar 2024 – 31 Dhjetor 2024**

| **Nr. Rendor** | **Data e kërkesës** | **Objekti i kërkesës** | **Data e përgjigjes** | **Përgjigje** | **Mënyra e përfundimit të kërkesës** | **Tarifa** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri Rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve | Data e regjistrimit të kërkesës | Përmbledhje e objektit të kërkesës, duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi | Data e kthimit të përgjigjes | Përmbajtja e përgjigjes, duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi | Përgjigja jepet: E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar | Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik |
| 1. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 09.01.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Z.E.P., në cilësinë e gjyqtarit, nëse ka ndonjë gjykim në lidhje me shtetasin A.P. pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 16.01.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.185 Prot., datë 09.01.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 01, datë 09.01.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: "- Pas verifikimit të kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS) nga ana e Kryesekretarisë së Gjykatës, nuk rezulton të jetë në shqyrtim, | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | apo të ketë përfunduar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ndonjë çështje gjyqësore civile, apo penale, që i përket shtetasit A.P.”. Ju bëjmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.185 Prot., datë 09.01.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 01, datë 09.01.2024, iu vu në dispozicion Kryesekretares së Gjykatës, Znj. (….) dhe Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 2. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 09.01.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Znj.E.T., si përfaqësuese e palës së paditur Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në lidhje me kërkesë-padinë dhe aktet shkresore të një çështje gjyqësore civile që është duke u shqyrtuar pranë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 11.01.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.184 Prot., datë 09.01.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 02, datë 09.01.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Kërkesë-padinë dhe aktet shkresore që i përkasin çështjes civile me palë paditëse: M.S., çështje e cila po shqyrtohet pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nga gjyqtarja (….)”. Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.184 Prot., datë 09.01.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 02, datë 09.01.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtares së Çështjes, Znj. (….)dhe Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 3. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 25.01.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Znj.F.M., në cilësinë e gazetares së (….), në lidhje me një ngjarje abuzimi të të miturës, ku dënimi i autorëve është dhënë prej pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 29.01.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.731 Prot., datë 25.01.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 03, datë 25.01.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: - Si në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS), ashtu edhe në regjistrat/numëratorët manualë në të cilët pasqyrohet e gjithë veprimtaria e punës së Gjykatës, nuk gjenerohen të dhëna duke vendosur ngjarjen, por këto të dhëna përftohen | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | vetëm duke vendosur identitetin e plotë dhe të saktë të palëve, pavarësisht pozitës së tyre proceduriale (paditës/i paditur/kërkues/person i tretë, person nën hetim/i pandehur). Ju bëjmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.731 Prot., datë 25.01.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 03, datë 25.01.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 4. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 30.01.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Znj.J.T., si përfaqësuese e kompanisë së sigurimeve (….), në lidhje me çështjet penale në ngarkim të personave nën hetim: A.M.; A.B.; E.Q. dhe D.M., në cilën faze të gjykimit janë çështjet e sipërcituara dhe nëse janë pushuar/ankimuar. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 05.02.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.933 Prot., datë 30.01.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 04, datë 30.01.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Informacion/dokumentacion në lidhje me çështjet penale që i përkasin palës kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kundër | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | personave nën hetim shtetasit: A.M.; A.B.; E.Q. dhe D.M., të nxjerra nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS), si dhe nga Kryesekretaria e Gjykatës. Më lejoni t'Ju informoj se, nga verifikimi i kryer rezulton se vetëm çështja penale që i përket palës kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kundër personit nën hetim: D.M., me objekt: *"Pushimin e procedimit penal nr. (….) viti (….)"*, është në gjykim, ndërsa për çështjet e tjera penale Gjykata ka vendosur: *"Pushimin e procedimit penal".* Përsa i përket faktit nëse ndaj çështjeve të përfunduara është paraqitur ankim, Ju informojmë se nga Kryesekretaria e Gjykatës na është komunikuar se në lidhje me çështjet penale ndaj personave nën hetim A.M. dhe A.B., vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka marrë formë të prerë. Ndërsa për çështjen penale ndaj personit nën hetim E.Q., deri në këto momente nuk është paraqitur ankim dhe nëse | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nuk paraqitet ankim, vendimi merr formë të prerë në datën 17.02.2024. Bashkëngjitur po Ju vëmë në dispozicion: *"Informacion dhe skedulin e çështjes penale ndaj personit nën hetim D.M., e cila është ende në gjykim, të nxjerrë nga sistemi elektronik"*. Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.933 Prot., datë 30.01.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 04, datë 30.01.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 5. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 05.02.2024 | Kërkesë për informacion nga Av.O.S, si përfaqësuese e viktimës O.Gj., në lidhje me planifikimin e seancës së ardhshme, duke qenë se kanë paraqitur kërkesë për shtyrje séance, si dhe kopje të procesverbalit të seancës së datës 05.02.2024. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 09.02.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1133 Prot., datë 05.02.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 05, datë 05.02.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion dhe procesverbalin e çështjes penale me Nr. (….)-(….)-62-2023 Regj.Them., që i përket palës kërkuese: Prokuroria pranë | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kundër të pandehurve: A.H., etj., viktimë: O.Gj., etj., të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS). 2. Seanca e ardhshme gjyqësore është planifikuar të zhvillohet në datën (….).(….).2024, ora 12:30”. Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.1133 Prot., datë 05.02.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 05, datë 05.02.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 6. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 07.02.2024 (protokolluar në datën 08.02.2024, pasi nuk kishte shërbim interneti në Gjykatë në datën 07.02.2024) | Kërkesë për informacion nga Znj.M.G., në lidhje me numrin e kërkesave të shqyrtuara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën 2017-2023, me object: “Lejim lidhje | Kthim përgjigje me E-mail më datë 09.02.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.1272 Prot., datë 08.02.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 06, datë 08.02.2024 (Kërkesa është paraqitur në datën 07.02.2024, por është protokolluar dhe | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | martese" dhe nga kush janë paraqitur këto kërkesa të ndara sipas vajzave dhe djemve. | | regjistruar në datën 08.02.2024, për shkak se nuk kishte shërbim interneti në Gjykatë në datën 07.02.2024). Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: 1. Informacion në lidhje me kërkesat familjare me objekt: "Lejim lidhje martese" të shqyrtuara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2023, si më poshtë cituar: - Në vitin 2017, janë paraqitur 3 kërkesa gjithsej, dy prej tyre janë paraqitur nga vajza dhe djali të dy në cilësinë e palës kërkuese, ndërsa 1 kërkesë është paraqitur nga vajza. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës kërkesës lejimin e lidhjes së martesës në 2 prej tyre, ndërsa për 1 kërkesë është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes. - Në vitin 2018 dhe në vitin 2019 nuk është shqyrtuar asnjë kërkesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier Fier, me objekt: "Lejim lidhje martese". - Në vitin 2020, është paraqitur vetëm 1 kërkesë, nga vajza dhe djali të dy në cilësinë e palës kërkuese dhe për këtë kërkesë është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes. - Në vitin | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 2021, është paraqitur vetëm 1 kërkesë, ku në cilësinë e palë kërkuese është vajza dhe për këtë kërkesë gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës, lejimin e lidhjes së martesës. - Në vitin 2022 dhe në vitin 2023 nuk është shqyrtuar asnjë kërkesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me objekt: “Lejim lidhje martese”. Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.1272 Prot., datë 08.02.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 06, datë 08.02.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 7. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 09.02.2024 | Kërkesë për informacion nga Znj.M.B., në cilësinë e kandidatit për prokuror në Shkollën e Magjistraturës, në lidhje me një vendim gjyqësor të dhënë prej Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, | Kthim përgjigje me E-mail më datë 09.02.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, të ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.1273 Prot., datë 08.02.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 07, datë 08.02.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: “Çështja penale që i përket palës | Refuzuar | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në ngarkim të shtetasit F.H. | | kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kundër të pandehurit: F.H., akuzuar për veprat penale të: *" Vrasjes me paramendim"*, është ende në shqyrtim, pasi nuk janë ezauruar të gjitha shkallët e gjyqësorit. Rezulton se: "***Ju nuk jeni palë në këtë gjykim, nuk jeni as përfaqësues i palëve në gjykim dhe as nuk i keni paraqitur Gjykatës bashkangjitur kërkesës, interesin Tuaj të ligjshëm për marrjen e këtij vendimi, apo pëlqimin e subjektit të të dhënave".*** Gjithashtu, Ju nuk jeni të autorizuar të përdorni për qëllime shkencore, apo akademike të dhënat e kësaj çështje. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në Nenin 15, pika 1 dhe 2 të saj, përcakton qartë se: ***"1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre".*** Në Nenin 35, pika 2 e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet detyrimi që: ***“Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj”.*** Gjithashtu, më lejoni t’Ju bëj me dije se vendimi gjyqësor përmban: ***“Të dhëna personale dhe të dhëna sensitive”*** në përputhje me nenin 2, me nenin 3 pika “1” dhe “2”, si dhe në nenin 5 të ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, të ndryshuar. Të dhënat personale jepen vetëm në rastet kur ato nevojiten për përmushjen e një detyrimi të parashikuar ligjor. Referuar nenit 17, pika 1, gërma “a” të Ligjit nr.119/2014, “*Për të drejtën e Informimit*”, përcaktohet qartë se e drejta për informim mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: ***“të drejtën për një jetë private”***. Kjo e drejtë nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës, ose kur në momentin e dhënies së | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Për të gjitha arsyet e sipërcituara, në respektim të privatësisë së palëve në proces, vlerësojmë se informacioni/dokumentacioni i kërkuar është i mbrojtur nga ligjet në fuqi dhe nuk mund t'Ju vihet në dispozicion nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.1273 Prot., datë 08.02.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 07, datë 08.02.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtares së Çështjes, Znj. (….) dhe Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 8. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 09.02.2024 | Kërkesë për informacion nga Av.E.M., si përfaqësues Komitetit Shqiptar të Helsinkit, në lidhje me planifikimin e seancës të një çështje penale me viktimë: Z.Q.Rr., çështje e cila është duke u shqyrtuar | Kthim përgjigje me E-mail më datë 09.02.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", të ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.1323 Prot., datë 09.02.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 08, datë 09.02.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. | | Informacion dhe skedulin e çështjes penale me Nr. (….)-(….)-62-2024 Regj.Them., që i përket palës kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me objekt: "Pushimin e procedimit penal nr.(….) viti 202(….)", viktimë: Q.Rr, etj., të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS). Deri ditën e sotme, nuk është planifikuar ndonjë seancë për këtë çështje". Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.1323 Prot., datë 09.02.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 08, datë 09.02.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 9. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 04.03.2024 (pas orarit zyrtar) | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Znj.E.K., në cilësinë e gazetares së (….), në lidhje me kërkesat për urdhër mbrojtje dhe urdhër të | Kthim përgjigje me E-mail më datë 06.03.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.2196 Prot., datë 04.03.2024, për dhënie | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | menjëhershëm të mbrojtjes të regjistruara dhe të përfunduara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën 01 Janar 2022 – 29 Shkurt 2024. | | informacioni, rregjistruar me numër rendor 09, datë 05.03.2024 (pasi është paraqitur pas orarit zyrtar të punës).Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: 1- Informacion/dokumentacion në lidhje me çështjet gjyqësore civile me objekt: “*Lëshim urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*” dhe “*Lëshim urdhëri mbrojtje*”, të regjistruara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022, 01 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2023, 01 Janar 2024 – 29 Shkurt 2024, si më poshtë cituar: -Për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022 janë regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, gjithsej 282 kërkesa, me objekt: *“Lëshim i urdhërit të zakonshëm të mbrojtjes/Lëshim i urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*”. - Për periudhën 01 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2023 janë regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, gjithsej 305 kërkesa, me objekt: *“Lëshim i urdhërit të zakonshëm të mbrojtjes/Lëshim i urdhëri të menjëhershëm të* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *mbrojtjes*". - Për periudhën 01 Janar 2024 – 29 Shkurt 2024, janë regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, gjithsej 83 kërkesa, me objekt: *"Lëshim i urdhërit të zakonshëm të mbrojtjes/Lëshim i urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*". 2 - Informacion/dokumentacion në lidhje me çështjet gjyqësore civile me objekt: "*Lëshim urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*" dhe "*Lëshim urdhëri mbrojtje*", të përfunduara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022, 01 Janar 2023– 31 Dhjetor 2023, si më poshtë cituar: - Për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022 janë shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier gjithsej 275 kërkesë-padi, nga të cilat 165 prej tyre kanë qenë me objekt: *"Lëshim i urdhërit të zakonshëm të mbrojtjes"* dhe 110 kërkesë-padi kanë qenë me objekt: "*Lëshim i urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*". Për 169 kërkesë-padi është vendosur: "Pranim i kërkesës", për 55 kërkesa është vendosur: "Pushimi i gjykimit" dhe për 51 kërkesa | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | është vendosur: “Rrëzim i kërkesës”. - Për periudhën 01 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2023 janë shqyrtuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier gjithsej 342 kërkesë-padi, nga të cilat 246 prej tyre kanë qenë me objekt: *“Lëshim i urdhërit të zakonshëm të mbrojtjes”* dhe 96 kërkesa kanë qenë me objekt: “*Lëshim i urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*”. Për 209 kërkesa është vendosur: “Pranim i kërkesës”, për 79 kërkesa është vendosur: “Pushimi i gjykimit” dhe për 54 kërkesa është vendosur: “Rrëzim i kërkesës”. Na lejoni t’Ju informojmë se, këto të dhëna që po Ju vihen në dispozicion janë statistikat zyrtare të raportuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, mbështetur në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006, “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”* të përditësuar, Udhëzimin nr. 9, datë 17.06.2020 "Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posacme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre", formulari nr.1 dhe formulari nr. 2, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | si dhe në Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.7, datë 15.06.2021 "Për një ndryshim në udhëzimin nr.9, datë 17.06.2020 "Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posacme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre". Gjithashtu, Ju bëjmë me dije se statistikat zyrtare nxirren, përpunohen dhe raportohen për çdo 3-Mujor. Për këtë arsye, nuk disponojmë të dhëna për 3-Mujorin e Parë 2024. Ju bëjmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.2196 Prot., datë 04.03.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 09, datë 05.03.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 10. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 15.03.2024 (ditë pushimi në bazë të vendimit të KLGJ- | Kërkesë për informacion nga Znj.I.SH., në cilësinë e kandidates për gjyqtare pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me çështjet | Kthim përgjigje me<br>E-mail<br>më datë<br>25.03.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", të ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.2658 Prot., datë 18.03.2024, për dhënie | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | së Nr.142, datë 15.03.2024) | gjyqësore të regjistruara dhe të përfunduara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, për periudhën 01 Janar 2023 – 31.12.2023. | | informacioni, rregjistruar me numër rendor 10, datë 18.03.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion/dokumentacion (statistikat zyrtare) në lidhje me çështjet gjyqësore penale *të regjistruara dhe të përfunduara* pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprën penale: "*Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor*", të parashikuara përkatësisht nga neni 290 të K.Penal, për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023". Janë regjistruar gjithsej të reja 33 çështje dhe janë përfunduar së shqyrtuari gjithsej 26 çështje me vendim fajësie (tek kolona rreshti 240). *Statistikat që po Ju vihen në dispozicion, janë statistikat zyrtare të raportuara nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.* Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.2658 Prot., datë 18.03.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 10, datë 18.03.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 26.03.2024 | Kërkesë për informacion nga Znj.K.M., në cilësinë e gazetares së "Zëri Al", në lidhje me çështjet gjyqësore të regjistruara dhe të përfunduara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprat penale kundër krimit mjedisor, për periudhën 01 Janar 2023 – 31.12.2023. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 27.03.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.2959 Prot., datë 26.03.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 11, datë 26.03.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion/dokumentacion (statistikat zyrtare) në lidhje me çështjet gjyqësore penale ***të regjistruara, të përfunduara dhe mbetur të papërfunduara*** pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për *"Veprat penale kundër mjedisit",* të parashikuara nga nenet 201-207 Kreu IV të K.Penal, për periudhën 01 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2023". *Bashkangjitur këtij e-maili, po Ju dërgojmë tabelën me të dhënat statistikore penale themeli ku përfshihen edhe "veprat penale kundër mjedisit" të raportuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën 01 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2023. Statistikat që po Ju vihen në dispozicion, janë statistikat* | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *zyrtare të raportuara nga Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.* Ju bëjmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.2959 Prot., datë 26.03.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 11, datë 26.03.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 12. | Kërkesë për informacion dërguar me shkresë më datë 11.04.2024 | Kërkesë për informacion nga Znj.V.Sh., në cilësinë e Komisioneres së "Avokatit të Popullit", në lidhje me çështjet gjyqësore që janë në proces shqyrtimi nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprat penale të parashikuara nga neni 76, 77, 78, 79 dhe 79/c të K.Penal, ku viktima kanë qenë gra, ose vajza; vënien në dispozicion të dokumentacionit të | Kthim përgjigje me shkresë më datë 18.04.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", të ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.3509 Prot., datë 11.04.2024, për dhënie informacioni, , rregjistruar me numër rendor 12, datë 11.04.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion/dokumentacion në lidhje me çështjet gjyqësore penale *që janë në shqyrtim* pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 77, 78, 79 dhe 79/c të K.Penal, si më poshtë cituar: - Nga verifikimet e kryera rezulton | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kërkuar në lidhje me këto çështje; si dhe caktimin e një personi kontakti pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me qëllim informimin në kohë në lidhje me zhvillimet e seancave gjyqësore për çështjet e sipërcituara. | | se nuk ka asnjë çështje gjyqësore e cila të jetë duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 77, 78, 79 dhe 79/c të K.Penal, ku viktima kanë qenë gra ose vajza, të klasifikuara si Femicide. - Caktimin e Personit të Kontaktit për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Znj.S.Gj, me Nr.Tel. (….), me detyrë Specialiste IT pranë Gjykatës, e cila administron faqen zyrtare si dhe postën elektronike të Gjykatës: gjykata.fier@gjykata.gov.al”. Më lejoni t'Ju shpreh mirënjohje për punën Tuaj, si dhe gadishmërinë tonë për të bashkëpunuar! | | |
| 13. | Kërkesë për informacion dërguar me shkresë më datë 16.04.2024 | Kërkesë për informacion nga Znj.M.Sh., në cilësinë e palës së paditur, përmes të cilës kërkon ndryshimin e vendimit gjyqësor të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 18.04.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", të ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.3698 Prot., datë 16.04.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 13, datë 16.04.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: "-Nga verifikimi i kryer në sistemin | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | elektronik të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS), rezulton se pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me vendimin gjyqësor Nr.62-2024-(….), datë (….)/(….)/2024, ka përfunduar së shqyrtuari çështja civile që i përket palës paditëse: K.M.; palëve të paditura: A.Sh. dhe M.Sh.; me objekt: *"Lëshimi i Urdhërit të Mbrojtjes"*, bazuar në Ligjin Nr.9669, datë 18.12.2006 *"Për masa ndaj dhunës në marrëdheniet familjare"*, i ndryshuar. -Në cilësinë e palës së paditur deklaroni se nuk jeni dakort me vendimmarrjen e gjykatës". Na lejoni t'Ju informojmë që: *"Në shtetin e së drejtës, mjeti ligjor për të kundërshtuar një vendim gjyqësor është ankimi në një gjykatë më të lartë, sipas legjislacionit në fuqi".* Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton se gjyqtarët janë të pavarur në ushtrimin e funksioneve, i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve dhe se ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave, ose të gjyqtarëve, passjell përgjegjësi sipas ligjit. Dhënia e drejtësisë duhet të jetë e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | çliruar nga çdo lloj ndikimi, ndërhyrjeje të subjekteve publike ose private. Në shtetin e së drejtës, mjeti ligjor për të kundërshtuar një vendim gjyqësor është ankimi në një gjykatë më të lartë. Pavarësia e gjyqësorit mbështetet edhe në nenin 4, Pika 3 dhe 6 të Ligjit nr.98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet se: "3. *Gjyqtarët, gjatë ushtrimit të funksionit dhe vendimmarrjes, janë të pavarur dhe të paanshëm". 6. Çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor sjell përgjegjësi sipas ligjit*". Në rast se Ju nuk zotëroni njohuritë e duhura juridike dhe nuk keni mundësi për të marrë një mbrojtës, më lejoni t'Ju sqaroj se, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ofron ndihmë juridike falas Av.R.M., me seli të zyrës: "Fier, lagjja: "29 Nëntori", rruga: "Dervish Hekali", Fier"; me adresë elektronike: (….)@yahoo.com. Ju informoj se formularët për ndihmë juridike mund t'i gjeni në çdo kohë elektronikisht në faqen zyrtare të: Ministrisë së Drejtësisë - www.drejtesia.gov.al; Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas - | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | www.ndihmajuridike.gov.al; Facebook: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Instagram: Drejtoriandihmësjuridikefalas. Ndihma juridike parësore mund të përfitohet edhe ONLINE: Në platformën www.juristionline.al; si dhe Përmes numrit të telefonit falas 08001010; Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.3698 Prot., datë 16.04.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 13, datë 16.04.2024, iu vu në dispozicion ZV/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Znj. (….) dhe Gjyqtarit të Medias të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). *Duke shpresuar se Ju kemi ardhur sadopak në ndihmë, faleminderit për mirëkuptimin!* | | |
| 14. | Kërkesë për informacion dërguar me shkresë më datë 17.04.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në lidhje me vendimet gjyqësore të pafajësisë të | Kthim përgjigje me shkresë më datë 29.04.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", të ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.3769 Prot., datë 17.04.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 14, datë 17.04.2024. Pas shqyrtimit të | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për vitin 2023. | | kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion/dokumentacion, vendimet gjyqësore në lidhje me çështjet gjyqësore penale ***të përfunduara*** pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për vitin 2023 për të cilat Gjykata ka disponuar ndër të tjera me "Pafajësi", si më poshtë cituar: Vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (30 vendime)". Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.3769 Prot., datë 17.04.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 14, datë 17.04.2024, iu vu në dispozicion Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Znj.(….) dhe Gjyqtarit të Medias të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 15. | Kërkesë për informacion dërguar me shkresë më datë 07.05.2024 | Kërkesë për informacion nga Z.V.I., në cilësinë e palës paditëse, përmes të cilës kërkon nga Zv/Kryetarja e Gjykatës së Shkallës | Kthim përgjigje me shkresë më datë 10.05.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", të ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.4382 Prot., datë 07.05.2024, për dhënie | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier të përjashtojë gjyqtarin (….) nga shqyrtimi I çështjes të tij. | | informacioni, rregjistruar me numër rendor 15, datë 07.05.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Informacion mbi çështjen, RIV (Regjistri i Veprimeve) dhe Skedulin e çështjes civile me Nr. (….) -(….)-62-2024, datë (….) 04/2024 regjistrimi, që i përket palës paditëse: që i përket Palës paditëse: V.I.; Palë të paditura: (….); dhe Person i tretë: (….) të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS). Ju informojmë se, duke qenë një çështje e pushuar më parë nga gjyqtari (….), çështja e sipërcituar është “Rihapur” dhe i ka rënë për shqyrtim po të njëjtit gjyqtar (….). Deri në këto momente, nuk është planifikuar ndonjë datë seance nga gjyqtari që ka në shqyrtim çështjen Tuaj. Ju do të njoftoheni nga ana e Gjykatës në lidhje me veprimet paraprake të gjyqtarit të vetëm”. Në lidhje me sa parashtroni në kërkesën Tuaj me nr.4382 Prot., datë 07.05.2024, Ju informojmë se mund t’i drejtoheni Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Përgjithshëm Fier me kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit. Neni 74 i Kodit të Procedurës Civile përcakton rregulla të qarta për përjashtimin e gjyqtarit. Ndërsa në nenin 75 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet shprehimisht që: ***“Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në seancë nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë. Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar”.*** Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.4382 Prot., datë 07.05.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 15, datë 07.05.2024, iu vu në dispozicion Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Znj. (….) dhe Gjyqtarit të Çështjes dhe të Medias të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 16. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 07.05.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Znj.E.A., në cilësinë e gazetares së (….), në lidhje me tre ngjarje | Kthim përgjigje me E-mail më datë 10.05.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, të | Refuzuar | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe më konkretisht "*Vjedhje të objekteve të kultit*", nëse në lidhje me këto ngjarje a janë regjistruar kërkesa për gjykim, apo kanë përfunduar me vendim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ngjarje të ndodhura në vitet: 2004, 2007 dhe 2011. | | ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.4475 Prot., datë 08.05.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 16, datë 08.05.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: "Si në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS), ashtu edhe në regjistrat/numëratorët manualë në të cilët pasqyrohet e gjithë veprimtaria e punës së Gjykatës, nuk gjenerohen të dhëna duke vendosur ngjarjen apo objektin, por këto të dhëna përftohen vetëm duke vendosur identitetin e plotë dhe të saktë të palëve në gjykim, pavarësisht pozitës së tyre proceduriale (i arrestuar/ndaluar, person nën hetim/i pandehur, paditës/i paditur/kërkues/person i tretë). Referuar nenit 17, pika 4 të Ligjit nr.119/2014, "*Për të drejtën e Informimit*", përcaktohet qartë se e drejta për informim mund të kufizohet në rast se: ***"kërkesa mbetet e paqartë dhe bëhet i pamundur identifikimi i informacionit të kërkuar"***. Për gjenerimin e të dhënave të kërkuara prej Jush, duhen | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | studiuar dosjet gjyqësore penale për çështjet e përfunduara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Ky është një studim i mirëfilltë statistikor dhe nuk është një e dhënë statistikore që mund të nxirret nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, mbi të cilën pasqyrohet veprimtaria e punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Për arsyen e sipërcituar, informacioni/dokumentacioni i kërkuar është i pamundur t'Ju vihet në dispozicion nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Ju bëjmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.4475 Prot., datë 08.05.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 16, datë 08.05.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z.(….). Më lejoni t'Ju shpreh mirënjohje për punën Tuaj, si dhe gadishmërinë tonë për të bashkëpunuar! Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 17. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 13.05.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Znj.L.Ç. në cilësinë e gazetares së (….), në lidhje me operacionet policore të koduara: Tempulli 1; Tempulli 2; Tempulli 3…, kopje të kërkesave të masave te sigurimit dhe kërkesave për gjykim, si kopje të vendimeve gjyqësore në lidhje me masat e sigurimit, kopje të vendimeve të pushimit/të dënimit, të përfunduara pranë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprat penale të parashikuara nga Nenet 283/1; 283/2; 284; 284/1 dhe 278 të Kodit Penal, për periudhën Shtator 2023 – Tetor 2024. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 15.05.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", të ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.4576 Prot., datë 13.05.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 17, datë 13.05.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: "Si në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS), ashtu edhe në regjistrat/numëratorët manualë në të cilët pasqyrohet e gjithë veprimtaria e punës së Gjykatës, nuk gjenerohen të dhëna duke vendosur ngjarjen apo objektin, apo të gjenerohen të dhëna të kategorizuara sipas operacioneve policore, porn a lejoni t'Ju bëjmë me dije se këto të dhëna përftohen vetëm duke vendosur identitetin e plotë dhe të saktë të palëve në gjykim, pavarësisht pozitës së tyre proceduriale (i arrestuar/i ndaluar, person nën hetim/viktimë/i pandehur, paditës/i paditur/kërkues/person | Refuzuar | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | i tretë)”. Referuar nenit 17, pika 4 të Ligjit nr.119/2014, “*Për të drejtën e Informimit*”, përcaktohet qartë se e drejta për informim mund të kufizohet në rast se: ***“kërkesa mbetet e paqartë dhe bëhet i pamundur identifikimi i informacionit të kërkuar”***. Për gjenerimin e të dhënave të kërkuara prej Jush, duhen studiuar dosjet gjyqësore penale për çështjet e përfunduara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Ky është një studim i mirëfilltë statistikor dhe nuk është një e dhënë statistikore që mund të nxirret nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, mbi të cilën pasqyrohet veprimtaria e punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Për arsyen e sipërcituar, informacioni/dokumentacioni i kërkuar është objektivisht i pamundur t’Ju vihet në dispozicion nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Ju bëjmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.4576 Prot., datë 13.05.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 17, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | datë 13.05.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z.(….). Më lejoni t'Ju shpreh mirënjohje për punën Tuaj, si dhe gadishmërinë tonë për të bashkëpunuar! | | |
| 18. | Shkresë më datë 14.05.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Av.A.Gj., si përfaqësues i palës paditëse N.A., në lidhje me një çështje gjyqësore civile që është duke u shqyrtuar pranë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me objekt: "Njohje pronësie me parashkrim fitues", duke kërkuar përshpejtim të gjykim për shkak të problemeve familjare dhe shëndetësore të paditësit. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 16.05.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", të ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.4786/1 Prot., datë 14.05.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 18, datë 16.05.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni:Informacion mbi çështjen, RIV (Regjistri i Veprimeve) dhe skedulin e çështjes civile me Nr. (….)-(….)-62-2024, datë (….)/(….)/2024 regjistrimi, që i përket palës paditëse: N.A., pala e paditur: (….), me objekt: *"Fitim i pronës (….), me parashkrim fitues",* të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS). Ju informojmë se çështja e | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | sipërcituar është regjistruar në datën (….)/(….)/2024 dhe është shortuar në datën (….)/(….)/2024. Nga shorti rezulton se kjo çështje civile i ka rënë për shqyrtim gjyqtares (….). Nga ana e Gjykatës jemi vënë në dijeni në lidhje me fazën proceduriale në të cilën ndodhet kjo çështje dhe më konkretisht: "Në zbatim të neneve 154/a dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata pasi e ka vlerësuar padinë pa të meta, i ka kërkuar palës së paditur (….) të lëshojë deklaratën e mbrojtjes, jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi i kërkesë-padisë, duke i bashkangjitur të gjitha të dhënat dhe provat e kërkuara nga neni 158 të K.Pr.Civile. Ju do të njoftoheni nga ana e gjykatës në lidhje me veprimet proceduriale. Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.4786 Prot., datë 14.05.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 18, datë 16.05.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtares së Çështjes, Znj. (….) dhe Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 19. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 28.05.2024 | Kërkesë për informacion nga Av.R.M., si përfaqësuese palës paditëse E.L, në lidhje me regjistrimin dhe shortimin e një çështje civile të paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nëpërmjet shërbimit postar. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 29.05.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, të ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.5142 Prot., datë 28.05.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 19, datë 28.05.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Informacion mbi çështjen, RIV (Regjistri i Veprimeve) dhe skedulin e çështjes civile me Nr. 2(….)-(….)-62-2024, datë (….)/(….)/2024 regjistrimi, që i përket palës paditëse: E.L., pala e paditur: S.L., me objekt: *“(….), etj.”*, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS)”. Ju informojmë se çështja e sipërcituar është regjistruar në datën (….)/(….)/2024 dhe është shortuar në datën (….)/(….)/2024. Kjo çështje i ka rënë për shqyrtim gjyqtarit (….). Deri në këto momente, nuk është planifikuar data e seancës së pajtimit nga ana e gjyqtarit të cilit i ka rënë për shqyrtim çështja. Ju do të | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | njoftoheni nga ana e Gjykatës në lidhje me veprimet paraprake të gjyqtarit të vetëm. Ju bëjmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.5142 Prot., datë 28.05.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 19, datë 28.05.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z.(….). | | |
| 20. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 22.07.2024 | Kërkesë për informacion nga Gazetari Z.E.Q., në lidhje me një vendim dënimi të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për të pandehurën M.H. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 25.07.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit" i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.7157 Prot., datë 22.07.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 20, datë 22.07.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: "1. Vendimin gjyqësor me Nr. 62-2024-(….) Vendimi, datë (….).(….).2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, të anonimizuar". Ju bëjmë me dije se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.7157 Prot., datë 22.07.2024, për dhënie informacioni, | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | rregjistruar me numër rendor 20, datë 22.07.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z. (….). | | |
| 21. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 24.07.2024 | Kërkesë për informacion nga Znj.E.H., në cilësinë e palës paditëse, në lidhje me komunikimin e një vendim gjyqësor të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 25.07.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.7246 Prot., datë 24.07.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 21, datë 24.07.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: « 1. Informacion dhe dispozitivin e çështjes civile me Nr. (….)-(….)-62-2021-R Regj.Them., Nr. 62-2024-(….) Vendimi, që i përket palës paditëse: E.H.; palë e paditur: P.H., me objekt: *"Njohje e të drejtës së bashkëpronësisë"*. Na lejoni t'ju informojmë se nga verifikimet e kryera rezulton se vendimi gjyqësor nuk është depozituar në Kryesekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Sapo vendimi gjyqësor i sipërcituar të depozitohet i arsyetuar, ai do t'ju komunikohet | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nga ana e K/Sekretarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Ju bëjmë me dije se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.7246 Prot., datë 24.07.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 21, datë 24.07.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z. (….) dhe Kryesekretares së Gjykatës, znj. (….). | | |
| 22. | Shkresë më datë 05.08.2024 (Muaji Gusht Leja Vjetore) | Kërkesë për informacion nga Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës (….), Znj.B.P., në lidhje me numrin e procedimeve të regjistruara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për veprat penale të parashikuara nga Nenet: 110/a; 128/b dhe 114 të Kodit Penal, për periudhën 2021-2023, të ndara sipas objektit dhe | Kthim përgjigje me shkresë më datë 12.09.2024 (Muaji Gusht Leja Vjetore) | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit" i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.7699 Prot., datë 05.08.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 22, datë 02.09.2024 (për shkak të lejes vjetore në muajin Gusht). Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion/dokumentacion (statistikat zyrtare dhe vendimet gjyqësore të anonimizuara) në lidhje me çështjet gjyqësore penale ***të regjistruara dhe të*** | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | viteve. Venien në dispozicion të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lidhje me veprat penale të sipërcituara dhe informacion në lidhje me sa prej rasteve është vendosur pafajësi. | | ***përfunduara*** pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprat penale të parashikuara përkatësisht nga Nenet: 110/a; 128/b dhe 114 të Kodit Penal, për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023. 2. Ju informojmë se, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për periudhën: 01 Janar 2021 - 31 Dhjetor 2023, janë dhënë vetëm tre vendime gjyqësore penale, që i përkasin veprave penale të parashikuara nga Nenet: 113/1, 114/1/2 dhe 115 të Kodit Penal, si më poshtë cituar: a. Vendimin gjyqësor penal me Nr. 62-2021-(….) Vendimi, datë (….).(….).2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprat penale të parashikuara nga nenet 114/2 dhe 115 dhe 113/1 të Kodit Penal, të anonimizuar. B. Vendimin gjyqësor penal me Nr. 62-2022-(….) Vendimi, datë (….).(….).2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprat penale të parashikuara nga nenet 114/1, 115 dhe 113 të Kodit Penal, të anonimizuar. C. Vendimin gjyqësor penal me Nr.62-2023- | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | (….) Vendimi, datë (….).(….).2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprën penale të parashikuar nga nenet 114/2, 115 dhe 180/1 të Kodit Penal, të anonimizuar. Vendimet gjyqësore të anonimizuara që po Ju vihen në dispozicion janë të shkarkuara nga adresa elektronike: www.gjykata.gov.al/gjykatafier.<br>3. Përsa i përket numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të parashikuara nga Nenet 110/a; 128/b dhe 114 të Kodit Penal, Ju bëjmë me dije se ky informacion disponohet nga organi i akuzës dhe më konkretisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Nga komunikimi dhe bashkëpunimi me koordinatoren e Prokurorisë Fier rezulton se për periudhën: 01 Janar 2021 - 31 Dhjetor 2023, për veprën penale të parashikuar nga Neni 114 I K.Penal, janë regjistruar: 2 çështje për vitin 2021; 1 çështje për vitin 2022 dhe 1 çështje për vitin 2023. Janë përfunduar në total 3 çështje (tre vendimet e sipërcituara) dhe është mbyllur 1 çështje e regjistruar në vitin 2021 dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përfunduar në datën (….)/(….)/2024, por nuk është zbardhur ende vendimi nga ana e Gjykatës (po Ju dërgojmë "Informacion dhe dispozitivin e kësaj çështje"). Në lidhje me veprat penale: "Trafikimin e personave të rritur" dhe "Trafikimin e të miturve", të parashikuar përkatësisht nga Nenet: 110/a dhe 128/b të Kodit Penal, referuar statistikave vjetore të Gjykatës, si dhe Sistemit Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS), Ju in formojmë se nuk ka asnjë çështje gjyqësore penale të përfunduar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën: 01 Janar 2021 - 31 Dhjetor 2023. Aktualisht është regjistruar në datën (….)/(….)/2024, për Vitin 2024 dhe është duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier çështja penale me Nr. (….)-(….)-62-2024, datë (….)/(….)/2024 regjistrimi, për veprat penale të parashikuara | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | nga Nenet 110/a/3, 115-25, 110/2. Në lidhje me këtë çështje e cila është duke u gjykuar për vitin 2024, po Ju vëmë në dispozicion “Informacion dhe skedulin e çështjes”. ***Statistikat që po Ju vihen në dispozicion, janë statistikat zyrtare të raportuara nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.*** Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.7699 Prot., datë 05.08.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 22, datë 02.09.2024, iu vu në dispozicion Zv/Kryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Znj. (….) dhe Gjyqtarit të Medias të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 23. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 04.09.2024 (protokolluar në datën 09.09.2024, pasi IT-ja e Gjykatës e cila administron adresën elektronike të | Kërkesë për informacion nga Z.S.C., në lidhje me numrin e kërkesave të shqyrtuara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën 2017-2023, me objekt: “Lejim lidhje | Kthim përgjigje me E-mail më datë 18.09.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit” i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.8316 Prot., datë 09.09.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 23, datë 09.09.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjykatës është me leje të zakonshme). | martese" dhe nga kush janë paraqitur këto kërkesa të ndara sipas gjinisë, si dhe kopje të vendimeve në lidhje me këto kërkesa. | | Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion në lidhje me kërkesat familjare me objekt: "Lejim lidhje martese" të shqyrtuara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2023, si më poshtë cituar: - Në vitin 2017, janë paraqitur 3 kërkesa gjithsej, dy prej tyre janë paraqitur nga vajza dhe djali të dy në cilësinë e palës kërkuese, ndërsa 1 kërkesë është paraqitur nga vajza. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës lejimin e lidhjes së martesës në 2 prej tyre, ndërsa për 1 kërkesë është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes. - Në vitin 2018 dhe në vitin 2019 nuk është shqyrtuar asnjë kërkesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier Fier, me objekt: "Lejim lidhje martese". - Në vitin 2020, është paraqitur vetëm 1 kërkesë, nga vajza dhe djali të dy në cilësinë e palës kërkuese dhe për këtë kërkesë është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes. - Në vitin 2021, është paraqitur vetëm 1 kërkesë, ku në cilësinë e palë kërkuese është vajza dhe për këtë kërkesë gjykata ka vendosur | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pranimin e kërkesës, lejimin e lidhjes së martesës. - Në vitin 2022 dhe në vitin 2023 nuk është shqyrtuar asnjë kërkesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me objekt: "Lejim lidhje martese". Bashkëlidhur gjeni: "Vendimet gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për çështjet e sipërcituara", të anonimizuara, të nxjerra nga portali gjykata.gov.al. Ju bëjmë me dije se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.8316 Prot., datë 09.09.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 23, datë 09.09.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z. (...). | | |
| 24. | Kërkesë për informacion dërguar me shkresë për kompetencë nga KLGJ më datë 06.09.2024. | Kërkesë për informacion nga Znj.J.C., në lidhje me numrin, shërbimet dhe mënyrën e pagesës së përkthyesve zyrtarë të gjuhës së huaj apo interpretive të gjuhës së shenjave që kanë ofruar | Kthim përgjigje me<br>E-mail<br>më datë<br>19.09.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit" i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.8265 Prot., datë 06.09.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 24, datë 06.09.2024, përcjellë për | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shërbimet e tyre pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, gjatë pesë viteve të fundit. | | kompetencë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Nr.4160/2 Prot., datë 03.09.2024 referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit" i ndryshuar. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion në lidhje me aspekte të ndryshme të marrëdhënies së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe përkthyesve zyrtarë të gjuhës së huaj apo interpretive të gjuhës së shenjave në procese penale, si më poshtë cituar: - Në lidhje me pyetjet: 1; 2; 3, Ju informojmë se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në buxhetin vjetor, midis zërave të tjerë të shpenzimeve, planifikon edhe shpenzime për përkthyes që përfshijnë përkthyes të gjuhëve të huaja, si dhe interpretëve të gjuhës së shenjave. Konkretisht në 5 vitet e fundit planifikimi dhe realizimi i pagesave të përkthyesve zyrtarë të gjuhës së huaj apo interpretive të gjuhës së shenjave në procese penale, kanë qenë si më poshtë: sipas tabelës. Përsa i përket pyetjes Nr. 4, Ju informojmë se | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier gjatë pesë viteve të fundit ka patur vetëm një proces penal me të pandehur person me aftësi të kufizuar në dëgjim dhe në të folur. - Në lidhje me pyetjen Nr. 5, përsa i përket procedurës së përzgjedhjes së përkthyesve të gjuhëve të huaja, si dhe interpretëve të gjuhës së shenjave, Ju informojmë se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier i referohet listës së ekspertëve të miratuar dhe të afishuar nga Ministria e Drejtësisë, në këto lista janë të afishuara edhe kontaktaktet e tyre. - Përsa i përket pyetjes Nr. 6, sqarojmë se pagesat e përkthyesve janë kryer në bazë të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave nr.3165 datë 12.05.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët” si dhe Udhëzimit nr.8 datë 19.07.2022 “Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike”. Afati i pagesave është deri 30 ditë nga lëshimi i faturës dhe dokumentacionit që vërteton kryerjen e shërbimit nga përkthyesi. - Në lidhje me pyetjen Nr. 7, nuk mund të kemi informacion se si ka funksionuar dhe se si është proceduar nga ana e Gjyqtarëve përpara çertifikimit të interpretëve të gjuhës së shenjave, nga Ministria e Drejtësisë. - Në lidhje me pyetjen Nr. 8, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nuk ka asnjë përgjegjësi për të paguar shërbimet e kryera nga përkthyesit e gjuhëve të huaja, si dhe interpretëve të gjuhës së shenjave, shërbime këto të ofruara në strukturat e Policisë dhe Prokurorisë për shtetasit e huaj, apo personat që nuk dëgjojnë. - Në lidhje me pyetjen Nr.9, në lidhje me refuzimet e përkthyesve të gjuhëve të huaja, si dhe interpretëve të gjuhës së shenjave, në pesë vitet e fundit, Ju informojmë se Gjykata e Shkallës | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është në pamundësi objektive për të gjeneruar këtë të dhënë, pasi këto të dhëna nxirren vetëm duke studiuar çdo dosje në të cilën ka qenë e nevojshme prania e ekspertëve të sipërcituar. - Në lidhje me pyetjen Nr.10, në lidhje me rastet e mospagesës së përkthyesve të gjuhëve të huaja, si dhe interpretëve të gjuhës së shenjave, në pesë vitet e fundit, Ju informojmë se nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nuk ka ndodhur asnjë rast. Ju bëjmë me dije se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.8265 Prot., datë 06.09.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 24, datë 06.09.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z. (….). | | |
| 25. | Kërkesë për informacion dërguar me shkresë për kompetencë nga KLGJ më datë 24.09.2024. | Kërkesë për informacion nga gazetarja e TV (….), znj.D.H., në lidhje me numrin e kërkesave të shqyrtuara pranë | Kthim përgjigje me E-mail më datë 30.09.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit” i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.8710 | E plotë | Falas |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën: 2021, 2022, 2023, deri ne Gusht 2024, me objekt: "Lejim lidhje martese", informacion se nga cilat qytete dhe komunitetet i përkasin këto kërkesa dhe shkaqet kryesore. | | Prot., datë 24.09.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 25, datë 24.09.2024, përcjellë për kompetencë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Nr.4415/1 Prot., datë 20.09.2024 referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit" i ndryshuar. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion në lidhje me kërkesat familjare me objekt: "Lejim lidhje martese" të shqyrtuara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën 01.01.2021 – 30.06.2024, si më poshtë cituar: - Në vitin 2021, janë paraqitur 2 kërkesa me objekt: "Lejim lidhje martese", për të cilat gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës, lejimin e lidhjes së martesës. - Në vitet: 2022, 2023 dhe 01 Janar – 31 Gusht 2024, nuk është shqyrtuar asnjë kërkesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me objekt: "Lejim lidhje martese". Bashkëlidhur gjeni: "Vendimet gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për çështjet e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | sipërcituara”, të anonimizuara, të nxjerra nga portali gjykata.gov.al. Ju bëjmë me dije se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.8710 Prot., datë 24.09.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 25, datë 24.09.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z. (….). | | |
| 26. | Kërkesë për informacion dërguar me shkresë për kompetencë nga KLGJ më datë 27.09.2024. | Kërkesë për informacion nga Qendra (….), në lidhje me numrin e çështeve civile dhe penale të përfunduar, apo që janë duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën: 01 Janar 2024 – 01 Shtator 2024, ose të mbartura nga viti i kaluar, ku një ndër palët ndërgjyqëse të jetë: “gazetar/punonjës të medias”. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 02.10.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit” i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.8863 Prot., datë 27.09.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 26, datë 27.09.2024, përcjellë për kompetencë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Nr.4549/1 Prot., datë 25.09.2024 referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit” i ndryshuar. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: “Informacion në lidhje me çështjet si më poshtë cituar: 1. Për periudhën 01 Janar – 01 Shtator | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 2024, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nuk është shqyrtuar asnjë çështe civile, me objekt të parashikuar nga nenet: 617, 625 dhe 647/a të Kodit Civil, me palë gazetar/punonjës të medias. 2. Për periudhën 01 Janar – 01 Shtator 2024, është duke u gjykuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier një çështje penale me palë gazetar/punonjës të medias dhe më konkretisht si palë e interesuar: "(….)" sh.p.k., për veprat penale të parashikuara përkatësisht nga nenet 119 të Kodit Penal "Fyerja" dhe 120 të Kodit Penal "Shpifja". Ndërsa për veprat e tjera penale të parashikuar nga nenet 121, 143/b dhe 186/a të Kodit Penal nuk ka të regjistruar, apo të përfunduar pranë Gjykatës, ku një ndër palët ndërgjyqëse të jetë gazetar/punonjës të medias. 3. Për periudhën 01 Janar – 01 Shtator 2024, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nuk ka asnjë çështje civile, apo penale të përfunduar ku një ndër palët ndërgjyqëse të jetë gazetar/punonjës të medias. 4. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Për periudhën 01 Janar – 01 Shtator 2024, është regjistruar në datën 21.03.2024 dhë është duke u gjykuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier një çështje penale me palë gazetar/punonjës të medias dhe më konkretisht si palë e interesuar: "(….)" sh.p.k., për veprat penale të parashikuara përkatësisht nga nenet 119 të Kodit Penal "Fyerja" dhe 120 të Kodit Penal "Shpifja". (bashkangjitur po Ju vëmë në dispozicion informacion mbi çështjen). Gjithashtu, Ju informojmë se ka vetëm një çështje penale të mbartur nga viti 2023, ku viktima janë gazetar/punonjës të medias, e cila është ende në shqyrtim pranë Gjykatës, për veprën penale të parashikuar nga nenet 110/1, 237 dhe 150 të Kodit Penal. (bashkangjitur "Informacion mbi çështjen"). 5. Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nuk disponohet asnjë regjistër të dhënash mbi gazetarët dhe punonjësit e mediave ku të regjistrohen rastet e padive/çështjeve ndaj tyre". Ju bëjmë me dije se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.8863 Prot., | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | datë 27.09.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 26, datë 27.09.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z. (….). | | |
| 27. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 11.10.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga z. E.Q., në cilësinë e gazetarit, në lidhje me një vendim mase sigurimi të dhënë prej Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 14.10.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit” i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.9400 Prot., datë 11.10.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 27, datë 11.10.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe marrjes së mendimit nga Gjyqtari i Medias dhe nga Gjyqtarja e Çështjes, na lejoni t’Ju informojmë se: “1. Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka përfunduar së shqyrtuari kërkesa penale që i përket palës kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kundër të arrestuarve shtetasit: Em.K.; Er.K., A.K; dhe T.Z., me objekt: “Vleftësimin e arrestimit në flagr ance dhe | Refuzuar | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | caktimin e masës së sigurimit", të dyshuar për kryerjen e veprave p enale: *"Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", e kryer në bashkëpuni m, "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", "Përkrahja e autorit të krimit",* të parashikuar nga nenet 79 gërma "dh" - 25, 278, 291 dhe 302/2 të Kodit Penal". Bazuar në nenin 279 të Kodit të Procedurës Penale kjo çështje është ende në "*Fazën e Hetimit Paraprak*" dhe Gjykata ka detyrimin ligjor për të ruajtur sekretin hetimor në kuadër të hetimeve të ndërmarra nga organi procedues. Rezulton se: "*Ju nuk jeni palë në këtë gjykim, nuk jeni as përfaqësues i palëve në gjykim dhe as nuk i keni paraqitur Gjykatës bashkangjitur kërkesës, interesin Tuaj të ligjshëm për marrjen e këtij vendimi, apo pëlqimin e subjektit të të dhënave".* Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në Nenin 15, pika 1 dhe 2 të saj, përcakton qartë se: *"1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*. Në Nenin 35, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet detyrimi që: *“Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj”.* Gjithashtu, më lejoni t’Ju bëj me dije se vendimi gjyqësor përmban: *“Të dhëna personale dhe të dhëna sensitive”* në përputhje me nenin 2, me nenin 3 pika “1” dhe “2”, si dhe në nenin 5 të ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar. Të dhënat personale jepen vetëm në rastet kur ato nevojiten për përmushjen e një detyrimi të parashikuar ligjor. Referuar nenit 17, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr.119/2014, “*Për të drejtën e Informimit*”, përcaktohet qartë se e drejta për informim mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: *"parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale"*. Kjo e drejtë nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës, ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Për më tepër, konstatojmë se në këtë ngjarje është i përfshirë edhe fëmijë i mitur në konflikt me ligjin. Vendimi gjyqësor civil përmban të dhëna që mbrohen nga ligji Nr.18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës". Në nenin 29 të ligjit të sipërcituar sanksionohet detyrimi që: "*Gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike". P*ër të gjitha arsyet e sipërcituara, në respektim të privatësisë së palëve në proces, vlerësojmë se informacioni/dokumentacioni i kërkuar është i mbrojtur nga ligjet në fuqi dhe nuk mund t'Ju vihet në dispozicion nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Përgjithshëm Fier. Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.9400 Prot., datë 11.10.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 27, datë 11.10.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtares së Çështjes, Znj. (….) dhe Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 28. | Kërkesë për informacion dërguar me shkresë më datë 07.11.2024 | Kërkesë për informacion nga përmbaruesi gjyqësor A.L., në cilësinë e palës paditëse, në lidhje me ecurinë e një çështje gjyqësore e cila është duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 08.11.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit" i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.10349 Prot., datë 07.11.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 28, datë 07.11.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion mbi çështjen dhe skedulin e çështjes civile me Nr. (….)-(….)-62-2024 Regj.Them., datë (….)/(….)/2024 Regjistrimi, që i përket: Palës paditëse: Zyra e Përmbarimit Privat "(….)" sh.p.k.; Palë të paditura: (….), etj.; Person i tretë: Agjencia Shtetërore e Kadastrës Fier; me objekt: "Veçim pjese | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | takuese për debitorin”, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS). Kjo çështje është shortuar në datën (….)/(….)/2024 dhe i ka rënë për gjykim gjyqtares znj. (….). Deri ditën e sotme nuk është planifikuar ndonjë seancë përgatitore/gjyqësore në lidhje me çështjen e sipërcituar, pasi Gjykata ka vijuar me veprimet paraprake që nga momenti që Ju keni plotësuar të metat e kërkesë-padisë. Ju do të njoftoheni nga ana e Gjykatës në lidhje me datën dhe orën e zhvillimit të seancës. Bashkangjitur po Ju dërgojmë edhe: Kodin e Anonimizimit: (….), përmes të cilit mund të merrni informacionin e nevojshëm në lidhje me çështjen Tuaj”. Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.10349 Prot., datë 07.11.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 28, datë 07.11.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtares së Çështjes, Znj. (….) dhe Gjyqtarit të Medias të Gjykatës së Shkallës së Parë e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 29. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 15.11.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Av.R.A., në cilësinë e përfaqësueses juridike të OJF-së (….), në lidhje me kërkesat për urdhër mbrojtje dhe urdhër të menjëhershëm të mbrojtjes të përfunduara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën 01 Janar 2024 – Nëntor 2024. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 18.11.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit" i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.10728 Prot., datë 15.11.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 29, datë 15.11.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion në lidhje me çështjet gjyqësore me objekt: "*Lëshim urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*" dhe "*Lëshim urdhëri mbrojtje*" të përfunduara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën 01.01.2024 – 30.09.2024, si më poshtë cituar: - Për periudhën 01 Janar 2024 – 30 Shtator 2024 janë shqyrtuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier gjithsej 325 kërkesë-padi, nga të cilat 280 prej tyre kanë qenë me objekt: *"Lëshim i urdhërit të zakonshëm të mbrojtjes"* dhe 45 kërkesë-padi kanë qenë me objekt: *"Lëshim i urdhëri të* | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *menjëhershëm të mbrojtjes*". Për 178 kërkesë-padi është vendosur: "Pranim i kërkesës", për 90 kërkesa është vendosur: "Pushimi i gjykimit" dhe për 57 kërkesa është vendosur: "Rrëzim i kërkesës". Na lejoni t'Ju informojmë se, këto të dhëna që po Ju vihen në dispozicion janë statistikat zyrtare të raportuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, mbështetur në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006, "*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*" të përditësuar, Udhëzimin nr. 9, datë 17.06.2020 "Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posacme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre", formulari nr.1 dhe formulari nr. 2, si dhe në Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.7, datë 15.06.2021 "Për një ndryshim në udhëzimin nr.9, datë 17.06.2020 "Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posacme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre". | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gjithashtu, Ju bëjmë me dije se statistikat zyrtare nxirren, përpunohen dhe raportohen për çdo 3-Mujor. Për këtë arsye, disponojmë të dhëna për 3-Mujorin e Parë; 3-Mujorin e Dytë dhe 3-Mujorin e Tretë 2024, si dhe 9-Mujore 2024. *Bashkangjitur këtij e-maili, po Ju dërgojmë tabelat e raportuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për periudhën 01 Janar 2024 – 30 Shtator 2024.* Ju bëjmë me dije se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.10728 Prot., datë 15.11.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 29, datë 15.11.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z. (….). | | |
| 30. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 21.11.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Av.A.B.., në cilësinë e mbrojtësit të të dënuarit N.M., në lidhje me ecurinë e gjykimit të kërkesës penale e cila është duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së | Kthim përgjigje me E-mail më datë 21.11.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit” i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.10977 Prot., datë 21.11.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 30, datë 21.11.2024. Pas shqyrtimit të | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. | | kërkesës dhe miratimit të saj nga Gjyqtarja e Çështjes dhe nga Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: 1. Informacion dhe skedulin e kërkesës penale me Nr. (….)-(….)-62-2024 Regj.Them., datë (….)/(….)/2024 Regjistrimi, që i përket palës kërkuese: N.M.; Palë e Interesuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me objekt: "Përfitim nga amnistia nr.33/2024", të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS). Gjykata ka shtyrë seancën gjyqësore të datës (….)/(….)/2024, me qëllim për të përseritur njoftimin për avokatin e të dënuarit, av.A.B., si dhe ka urdhëruar njoftimin e të dënuarit N.M., duke e vënë në dijeni në lidhje me pasojat ligjore në rast të mosparaqitjes në gjykim pa shkaqe të përligjura. Seanca e ardhshme gjyqësore është planifikuar të zhvillohet në datën (….)/(….)/2024 ora (….):(….). Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.10977 Prot., datë 21.11.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | numër rendor 30, datë 21.11.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtares së Çështjes, Znj. (….) dhe Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Z. (….). | | |
| 31. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 13.12.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Media (….), në lidhje me çështjet gjyqësore penale të përfunduara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën: 01.01.2015 – 30.09.2024, për veprat penale të parashikuara përkatësisht nga Nenet: 138; 138/a dhe 147 të Kodit Penal. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 16.12..2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit" i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.12704 Prot., datë 13.12.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 31, datë 13.12.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion/dokumentacion (statistikat zyrtare) në lidhje me çështjet gjyqësore penale *të regjistruara dhe të përfunduara* pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për periudhën: 01.01.2015 – 30.09.2024, për veprat penale të parashikuara përkatësisht nga Nenet: 138; 138/a dhe 147 të Kodit Penal, si më poshtë cituar: - Për periudhën: 01 Janar 2015 – 30 Shtator 2024, nuk është shqyrtuar | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier asnjë çështje penale për veprat penale të parashikuara përkatësisht nga Nenet 138; 138/a dhe 147 të Kodit Penal". *Bashkangjitur këtij e-maili, po Ju dërgojmë statistikat zyrtare penale të raportuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për periudhën: 01 Janar 2015 – 30 Shtator 2024, të cilat do t'i gjeni të kategorizuara sipas dispozitave ligjore përkatëse (Nenet janë vendosur në kolonën A dhe 1 në tabelë).* Sqaroj se për vitet 2015 – 2018 të dhënat për çështjet penale të parashikuara nga Nenet 138; 138/a dhe 147 të Kodit Penal i gjeni në Rreshtin: 108 - Neni 138; Rreshti 109 - Neni 138/a dhe Rreshti 123 – Neni 97 i Kodit Penal; Ndërsa për vitet 2019 – 30 Shtator 2024 i gjeni në Rreshtin: 76 - Neni 138; Rreshti 77 - Neni 138/a dhe Rreshti 97 – Neni 97 i Kodit Penal. Na lejoni t'Ju informojmë se, këto të dhëna që po Ju vihen në dispozicion janë statistikat zyrtare të raportuara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, bazuar në Urdhërin Nr.250, datë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 15.04.2019 “*Për miratimin e formateve të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore nga Gjykatat në Republikën e Shqipërisë*”; Udhëzimin nr.4, datë 15.04.2019 “*Për plotësimin e të dhënave statistikore*”, të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu, Ju bëjmë me dije se statistikat zyrtare nxirren, përpunohen dhe raportohen për çdo 3-Mujor. Për këtë arsye, disponojmë të dhëna për 3-Mujorin e Parë; 3-Mujorin e Dytë dhe 3-Mujorin e Tretë 2024, si dhe 9-Mujore 2024. Ju bëjmë me dije se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.12704 Prot., datë 13.12.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 31, datë 13.12.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z. (….). | | |
| 32. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 17.12.2024 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga znj. M.J e (….), në lidhje me numrin e çështjeve gjyqësore të regjistruara pranë Gjykatës së Shkallës | Kthim përgjigje me E-mail më datë 23.12.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit” i ndryshuar, kërkesën Tuaj nr.12863 Prot., datë 17.12.2024, | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, përpara dhe pas miratimit të hartës së re gjyqësore, përfshirë dhe organikën e gjyqtarëve. | | për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 32, datë 17.12.2024. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga Gjyqtarja e Çështjes dhe nga Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: "1. Historikun e shpërndarjes së çështjeve – Tabelë përmbledhëse sipas gjyqtarëve, për periudhën: nga data 01/01/2023, deri në datën 30/04/2023; si dhe për periudhën nga data 01/01/2024, deri në datën 30/04/2024, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS)". Në bazë të hartës së re gjyqësore, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka në organikën e saj 21 (njëzetë e një) gjyqtarë (bashkëlidhur gjeni strukturën organizative). Theksojmë faktin se gjatë gjithë kësaj periudhe ka patur lëvizje të gjyqtarëve, gjyqtarë që janë shkarkuar nga detyra me vendim të KPA-së për shkak të procesit të vettingut; gjyqtarë të vjetër në detyrë që promovohen në Gjykata më të larta, si dhe ardhja e gjyqtarëve të rinj nga Shkolla e Magjistraturës. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në datën 23 Tetor 2023 trupës gjyqësore prej 8 gjyqtarësh të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier iu shtuan edhe 6 gjyqtarë të rinj, duke shkuar gjithsej në 14 numri i gjyqtarëve. Deri në datën 02.10.2024 ushtronin detyrën pranë kësaj Gjykate 12 gjyqtarë. Pas kësaj date, trupës gjyqësore iu shtuan edhe 05 gjyqtarë të rinj dhe aktualisht është 17 (shtatëmbëdhjetë) numri i gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën e tyre pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Ju bëjmë me dije se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.12863 Prot., datë 17.12.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 32, datë 17.12.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z. (….). | | |
| 33. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 25.12.2024 (protokolluar në daten 26.12.2024, | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Av.I.D., si përfaqësues me procurë i shtetasit z.V.Gj., nëse klienti që ai përfaqëson ka | Kthim përgjigje me E-mail më datë 27.12.2024 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit” i ndryshuar, kërkesën Tuaj | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për shkak të festës zyrtare) | në shqyrtim ndonjë çështje gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. | | nr.13175 Prot., datë 25.12.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 33, datë 26.12.2024 (protokolluar një ditë më pas për shkak të festës zyrtare). Pas shqyrtimit të kërkesës dhe miratimit të saj nga Gjyqtari i Medias, bashkëngjitur gjeni: “1. Informacionin e nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS)”. Ju informojmë se, nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (ICMIS) rezulton se pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nuk ka asnjë çështje në shqyrtim në emër të shtetasit V.Gj. Ju bëjmë me dije se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.13175 Prot., datë 25.12.2024, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 33, datë 26.12.2024, iu vu në dispozicion Gjyqtarit të Medias pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, z(….). | | |